

Operacioni i murit ndarës të hundës (Operacioni i septumit të hundës)

Ju lutemi ta lexoni dhe ta plotësoni këtë fletë përpara bisedës sqaruese me mjekun!

E dashura paciente, i dashuri pacient, të dashur prindër,

muri ndarës i hundës (septumi i hundës), i cili në pjesën e përparme përbëhet nga kartilagoja dhe në pjesën e pasme nga fleta kockore, mbulohet nga mukoza dhe e ndan në dy gjysma hapësirën e hundës (hapësira kryesore e hundës; shih fig. 1 dhe 2); kalimi i ajrit bëhet ndaras në të dy anët.

Hulumtimet kanë treguar se tek ju/fëmija juaj

- Septumi i hundës tregon një **shtrembërim**, që mund të jetë ose i lindur ose nga thyerja e një ashti të hundës. Shtrembërimi e ngushton njëri nga të dy hapësirat e hundës dhe pengon frymëmarrjen me hundë.
- Përveç shtrembërimit të murit ndarës të hundës, hapësirën e hundës e ngushton edhe **ënjtja kronike e laprave të hundës**. Laprat ndërtojnë murin e jashtëm të hapësirës kryesore të hundës (shih fig. 2).

Pengimi i frymëmarrjes me hundë, mund të shkaktojë infekte përsëritëse të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes (p.sh., inflamacione të hapësirave pranë-hundore, të hapësirës së grykës dhe të trakesës), gërrhimë, pengesa në gjumë dhe dhembje koke.

- Septumi i hundës ka **një vrimë** (perforim të septumit), e cila mund të jetë formuar pas një dëmtimi të mukozës dhe mund të shkaktojë vështirësi (p.sh., zhurma fishkëlluese të frymëmarrjes, hemorragji përsëritëse nga hundët).

Ne ju rekomandojmë drejtimin e murit të hundës me operacion dhe, sipas gjendjes, zvogëlimin e laprave të hundës, respektivisht mbylljen e vrimës në murin ndarës të hundës.




Fig. 1: Prerja gjatësore nëpër hapësirat e hundës




Fig. 2: Prerja tërthore nëpër hapësirat kryesore të hundës



Rekomanduar nga
Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe
Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore
www.qkcsaish.gov.al



Rekomanduar nga
European Health Association



Rekomanduar nga
Deutscher Gesundheitshilfe e.V.



ALB-MED

Sistemi ALBmed për informimin e pacientit 02/06 Botues: Prof. W. Weißbauer, Prof. K. Ulsenheimer (legjislacion mjekësor).

Autorë: Prof. F. Bootz, Prof. W. Weißbauer. Ilustrimet: A. Gluska.

Copyright 2008 by ALB-MED, Rruga Adem Jashari p.n., 22000 Dragash, Kosovë, Telefon +377 (0)44 179 896. E-mail: info@alb-med.com

www.alb-med.com

Ndalohet dhe ndëshkohet me ligj fotokopjimi dhe shumëzimi i çfarëdo lloji.

Numri për porositje: 11/031

Operacioni

Bëhet me narkozë, e më rrallë me mpirje lokale. Metoda e parashikuar tek ju është shënuar me shenjën x brenda katrorit përkatës.

Drejtimi i septumit të hundës

Gjatë operacionit të septumit **të shtrembëruar** të hundës, pas një prerjeje në pjesën lëvizëse të septumit (kartilago, asht), në hyrje të hundës mukoza ngrihet. Largohen pjesët e tepërta të kartilagos, respektivisht të ashtit, pjesët e shtrembëruara të kartilagos mund të drejtohen me anë të prerjeve grithëse, në mënyrë që septumi i hundës të mund të qëndrojë i patendosur dhe në mes.

Kur shtrembërimet janë më të mëdha, shpesh nevojitet heqja e pjesëve të kartilagos dhe të ashtit, kurse rrallë e tërë septumit të hundës, të cilat, pasi drejtohen, mbillen sërish në vendin e tyre.

- Në qoftë se duhet të zvogëlohen **laprat e poshtme të hundës**,
 - Në laprën e hundës vendoset një elektrodë. Mukoza shkatërrohet me anë të nxehtësisë (**elektrokoagulacion**). Në vend të rrymës me frekuencë të lartë, mund të përdoret edhe një **laser**.
 - Prej të dy laprave të poshtme, shkurtohet mukoza për afro 2-3 milimetra (**shkurtimi i laprave**).
 - Pas shkoqitjes së bërthamës ashtërore të laprës, ajo shtyhet anash (**zhvendosja anash**).
 - Duke ruajtur mukozën, hiqen eshtrat e rritura (**reseksioni submukozal i laprës**).

Në fund të operacionit, në të dy hapësirat kryesore të hundës zakonisht vendoset nga një shinë prej silikoni, për ta mbrojtur septumin e hundës dhe për të siguruar përforcimin e tij në pozitë të mesit. Shinat mund të largohen pas 7 deri 14 ditësh, zakonisht në mënyrë ambulatorë. Në shumë raste, nevojitet të bëhet edhe tamponada e hundës.

Mbyllja me operacion e një vrimë në septumin e hundës

Një vrimë në septumin e hundës mund të mbyllet me operacion përmes transplantimit të mukozës ose përmes fletëve të silikonit.

Transplantimi i mukozës

Mukoza më e përshtatshme është ajo prej vetë septumit të hundës, e cila shtyhet nga pjesët e afërta kah vendi me defekt (vrime).

Në qoftë se përdoret mukoza e laprës së poshtme të hundës, atëherë për 4-6 javë, lapra e poshtme patjetër duhet të qëndrojë e lidhur me anë të një bishti (prej mukoze), përmes të cilit ajo siguron furnizimin me gjak. Ajo mund të ndahet vetëm pasi të jetë shëruar plotësisht mukoza në vendin e vrimës (defektit).

Kur defektet janë më të mëdha, është e përshtatshme mukoza e gojës prej faqes së brendshme të buzëve, e cila vendoset përgjatë defektit dhe qepet për nofullën e sipërme dhe bazën e hundës.

Ka edhe shumë metoda, të cilat përdoren më rrallë. Në qoftë se parashikohet ndonjëra nga ato metoda, ne do t'ju informojmë gjatë bisedës sqaruese.

Vendosja e fletëve prej silikoni

Kur defektet kanë madhësi serioze, më nuk është e mundshme mbyllja e tyre me anë të mukozës së trupit. Në këto raste, për mbylljen e defekteve mund të vendosen fletët prej silikoni.

Ju lutemi qysh tani të jepni pëlqimin për zgjerimet e domosdoshme ose të arsyeshme të trajtimit të parashikuar, në mënyrë që ato të mund të bëhen me të njëjtën anestezë dhe të evitohet trajtimi i sërishëm.

Cilat veprime anësore dhe komplikime mund të shfaqen?

Dëmtimet e enëve të gjakut, të cilat shkaktojnë **hemorragji të mëdha** ose **hemorragji të mëvonshme**, janë të rralla.

Dëmtimi i indeve nga rryma elektrike, është shumë i rrallë. Hemorragjitë zakonisht ndalen me anë të një tamponade (të sërishme), dhe, vetëm në raste të jashtëzakonshme, duhet të ndalen me anë të operacionit. Jashtëzakonisht rrallë ngjan që gjaku të hyjë në rrugët e frymëmarrjes. Kjo mund të shkaktojë zënien e frymës, deri te rreziku i mbytjes.

Grumbullimi i gjakut nën mukozë (hematoma e septumit) hiqet me anë të një prerjeje të vogël.

Janë shumë të rralla **lëndimet e bazës së kafkës** me dalje të lëngut trunor, të cilat, për shkak të rrezikut të inflamacionit të cipave trunore ose të një abscesi të trurit, kërkojnë një operacion tjetër. Është shumë i rrallë **dëmtimi** i përhershëm **i aftësisë së nuhatjes**.

Dobësimet e shikimit për një kohë të gjatë, e deri në humbjen e të parit, për shkak të hemorragjive në hapësirën e syrit, infeksioneve, veprimeve të padëshiruara të medikamenteve si dhe të mbylljes së enëve qendrore të syrit dhe të nervit optik si pasojë e injeksioneve, janë shumë të rralla.

Si pasojë e një infeksioni, rrallëherë krijohet një **absces** (abscesi i septumit), i cili pas një hapjeje me operacion, zakonisht shërohet pa kurrfarë pasojash.

Pas degjenerimit të kartilagosit së hundës, shumë rrallë shfaqet **hunda shalë**, e cila mund të rregullohet me anë të një operacioni korrektues.

Gjatë operimit të një vrimë të septumit të hundës, mund të ndodhë një defekt edhe më i madh në septum, veçanërisht kur përdoret mukoza e rrethinës. Mund të ndodhë ngjitja e laprës së hundës me septumin e hundës, e cila zakonisht mund të ndahet. Kur mukoza merret nga pjesa ndërmjet buzës dhe harkut të dhëmbëve, mund të krijohet një hapje komunikuese në mes të hundës dhe gojës, e cila duhet të mbyllet me operacion. Përveç kësaj, mund të shfaqet edhe kufizimi i lëvizshmërisë së buzës së sipërme nga shenja e operacionit.

Çrregullimet në shërimin e plagës mund ta bëjnë më të gjatë kohën e shërimit; për shkak të furnizimit të vogël me gjak, mund të shfaqet vdekja e indeve, e në raste të jashtëzakonshme (shumë të rralla), e tërë mukozës që është mbjellë me operacion për të mbuluar defektin ekzistues.

Në raste të veçanta, si komplikim shfaqet **tharja e mukozës së hundës** me **formim të krustave** dhe rrjedhja e hundëve me erë të rëndë (**hunda me erë të rëndë**), si dhe shumë rrallë, **ndjenja e thatësisë në grykë** dhe/ose **dëmtimi i përhershëm i aftësisë së nuhatjes**.

Shumë të rralla janë **dëmtimet** dhe **rritjet e vrugës** në brendinë e hundës, të cilat ngushtojnë rrugët e lotëve dhe, si pasojë, kanë **rrjedhjen e lotëve** ose **frymëmarrjen e vështirësuar me hundë**.

Kur ka **alergji** ose **mbindjeshmëri** (p.sh. ndaj medikamenteve, mjeteve dezinfektuese, lateksit), pas një kohe të shkurtër mund të shfaqen ënjtje, kruarje, teshtimë, të skuqura të lëkurës, marrje mendsh, të vjella dhe reaksione të ngjashme të lehta. **Komplikimet e funksioneve jetësore që rrezikojnë jetën** (të zemrës, qarkullimit, frymëmarrjes, veshkave) ose **dëmtimet e përhershme** (p.sh., paraliza, pamjaftueshmëria e organeve), janë shumë të rralla.

Çrregullimet e lehta të ndjeshmërisë dhe ngjyrosja e dhëmbëve të nofullës së sipërme, pas një kohe, tërhiqen zakonisht vetvetiu.

Rreziqet e përgjithshme të operacionit, sikurse janë dëmtimi i nervave nga shtypja dhe tërheqja gjatë narkozës si dhe formimi i koaguleve të gjakut (**tromboza**), dhe, sipas rrethanave, edhe bartja e trombëve me mbylljen e një ene të gjakut (**embolia**), janë shumë të rralla.

Masat parapërgatitore, shoqëruese dhe ato që pasojnë më vonë, nuk janë pa rreziqe. Kështu p.sh. rrallëherë infuzionet ose injektimet mund të shkaktojnë **dëmtime në vendin e injektimit** (abscese, nekroza, ngacmime dhe inflamacione të nervave dhe/ose të venave) si dhe **dëmtime kalimtare të nervave**, e rrallë të përhershme (dhembje, paraliza).

Me gjithë kujdesin e madh gjatë marrjes, ruajtjes dhe përpunimit të gjakut dhe prodhimeve të tij, nuk mund të përjashtohet plotësisht mundësia e **infektimit** pas dhënies/përdorimit të tyre, p.sh., shumë rrallë, me viruse të hepatitit (verdhëza), edhe më rrallë me HIV (AIDS), dhe me shkaktarët e sëmundjes së tërbimit të gjedhëve (BSE) përkatësisht me variantin e ri të sëmundjes Creutzfeld-Jakob.

Ju lutemi të pyetni mjekun në qoftë se dëshironi të dini më tepër lidhur me këtë.

Suksesi i mjekimit

Drejtimi i septumit të hundës, sipas nevojës, me zvogëlimin e laprës së poshtme të hundës, pothuaj gjithmonë përmirëson frymëmarrjen me hundë. Me këtë veprim parandalohen sëmundjet sekondare, siç janë infeksionet e shpeshta të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes.

Vraga e operacionit mund të shkaktojë tërheqje dhe shtrembërim të sërishëm të septumit të hundës, dhe kështu të vështirësojnë përsëri frymëmarrjen me hundë. Në varësi nga gjendja, në këto raste mund të nevojitet një korrekturë e re.

Ju lutemi të respektoni me përpikëri! Në qoftë se mjeku nuk urdhëron ndryshe!

Para operacionit

Operatori, në bashkëpunim me mjekun e sëmundjeve të gjakut vendos nëse dhe kur duhet të ndërpritet medikamenti për pengimin e mpiksjes së gjakut, respektivisht për zëvendësimin me një tjetër.

Në qoftë se operacioni bëhet me **anestezi lokale**:

- 4 orë para operacionit, mos tymosni duhan
- nëse mjeku nuk udhëzon ndryshe, para operacionit me mpirje lokale, nuk duhet të jeni esull. Mund të merrni ushqime të lehta dhe, deri para operacionit, mund të pini lëngje të kthjellëta (p.sh., çaj, ujë mineral).

Lidhur me narkozën dhe përgatitjet për të, do të informoheni në veçanti.

Pas operacionit

Në 8 ditët e para, mos i fryni kursesi hundët, edhe pasi të hiqet tamponada. Sekretioni i hundës duhet vetëm të fshihet. Gjatë teshtimës, goja të hapet gjerësisht. Evitoni ngacmimin dhe lëndimin e hundës.

Në 14 ditët e para, evitoni çdo gjë që shkakton ënjtje ose bën shtypje në hundë, p.sh., sforcimet fizike, aktivitetet sportive, noti, larja në vaskë të mbushur plot me ujë, qëndrimi në saunë dhe rrezatim.

Në rast se bartni syze, gjithmonë hiqni pas përdorimit. Thjerrat (lentat) kontakte mund të vihen menjëherë, në ditën e operacionit. Kujdes gjatë larjes së flokëve (mos e lakoni kokën)!

Ju lutemi të informoni menjëherë mjeken/mjekun tuaj, në qoftë shfaqen temperaturë (mbi 38°C), dhembje ose skuqje në rajonin e vrimave të hundës, ose për çrregullimet e gjendjes së përgjithshme. Kjo vlen për hemorragjitë nga hunda ose goja si dhe kollitjet me gjak, madje edhe nëse këto ndryshime shfaqen disa ditë pas operacionit.


Në qoftë se intervenimi bëhet në mënyrë **ambulatore**, duhet të siguroni një person të rritur i cili do t'ju shoqërojë deri në shtëpi, meqenëse aftësitë tuaja reaguese mund të jenë të kufizuara nga veprimi i medikamenteve kundër dhembjeve dhe/ose për anestezi. Ne do t'ju njoftojmë se kur mund të merrni pjesë aktive në trafik ose të punoni me makina lëvizëse. Gjatë kësaj kohe, nuk duhet të pini alkool dhe as të merrni vendime të rëndësishme.

Nënshkrimi i mjekes/mjekut: _____

Pyetësori (anamneza)

Pyetjeve vijuese, ju lutemi t'u përgjigjeni me kujdes, në mënyrë që të parandalojmë me sukses çfarëdo rreziku të mundshëm. Shënoni, nënvizoni respektivisht shkruani ato që janë të sakta për ju. Sipas nevojës, gjatë plotësimit të pyetësorit, ju ndihmojmë me gjithë dëshirë.

1. A merrni/ a merr fëmija juaj **medikamente**? Kundër dhembjeve, për pengimin e mpiksjes së gjakut (p.sh., Marcumar®, Aspirin®, ASS®), për qetësim, gjumë
- ose: _____
Në qoftë se e keni **librezën e Marcumar-it**, ju lutemi të na e tregoni.
2. A vuani / a vuan fëmija juaj nga **sëmundjet e zembrës dhe të qarkullimit** (p.sh., tensioni i lartë i gjakut, dhembje në gjoks, infarkti i zembrës, vese të zembrës)?
- ose _____
- A bartni ju/ a bart fëmija juaj, **pejsmeiker** ose **valvul artificiale**?
Në qoftë se e keni **librezën e pejsmejkerit**, ju lutemi të na e tregoni.
3. A jeni/ a është fëmija juaj i sëmurë nga sheqeri (**diabetik**)?
- A injektoni / a injekton fëmija juaj insulinë apo a merrni / a merr "tableta të diabetit"?
Në qoftë se e keni **librezën e diabetikut**, ju lutemi të na e tregoni.
4. A vuani / a vuan fëmija juaj prej **hemorragjive të shpeshta nga hundët, njollave** edhe pa dëmtim të indit, respektivisht pas shtypjeve të lehta, **çrregullimeve hemorragjike**?
5. A vuani nga **mbifunksioni i gjëndrës tiroide**?
6. A keni **sëmundje kronike** (p.sh., epilepsi, katarakt)?
- Nëse po, cilat? _____
7. A keni **alergji** (p.sh., ndaj barit, astmë) ose **mbindjeshmëri** ndaj medikamenteve kundër dhembjeve, anestetikëve lokalë, gjërave ushqimore, flasterit, lateksit, medikamenteve të tjerë?
- ose: _____
Në qoftë se e keni **librezën e alergjisë**, ju lutemi të na e tregoni.
8. A keni marrë / a ka marrë fëmija juaj, ndonjëherë **injeksion për anestezi lokale**?
- A ka pasur atëherë komplikime?
Nëse po, çfarë? _____
9. A keni / a ka fëmija juaj, **dhëmbë që luajnë** ose **zëvendësime dhëmbësh** (proteza, ura, dhëmbë të mbjellë)?
10. A është **vaksinuar** fëmija juaj gjatë dy javëve të fundit?
- Nëse po, kundër çkaje? _____
Në qoftë se e keni **librezën e vaksinimit**, ju lutemi të na e tregoni.
11. Për **gratë** në moshën e riprodhimit:
- A jeni **shtatzënë**?
- A e ushqeni fëmijën me gji?



Ju lutemi, nënvizoni tekstin, plotësoni me shkrim në vendet e parapara, shënoni x në katrorët përkatës që paraqesin gjendjen tuaj, dhe në fund, nënshkruani.

Për dokumentacion

Biseda sqaruese me mjekun

E kam lexuar dhe e kam kuptuar **pjesën për informimin e pacientit**. Kam pasur mundësi t'i bëj të gjitha pyetjet që më kanë interesuar. Për pyetjet e mia kam marrë përgjigje të plota dhe të qarta.

Pyetjeve për historinë e sëmundjes (anamnezën), u jam përgjigjur më së miri sipas dijes sime.

E mora me vete për ta ruajtur:

pjesën për informimin e pacientit

një fletë të pandarë.

Do të respektoj **udhëzimet** e dhëna.

Gjatë bisedës sqaruese me mjekun/mjekun (emri) _____

më janë sqaruar: zgjedhja e metodës, përparësitë dhe dobësitë krahasuar me metodat e tjera, komplikimet e mundshme, faktorët që rrisin rrezikun, ndërhyrjet eventuale ndihmëse dhe pasuese, si dhe (në vijim shënoni edhe ndryshimet e bëra me dorë në pjesën për informimin e pacientit):

Koha e parashikuar e ndërhyrjes (data): _____

Pëlqimi

E kam menduar mirë vendimin tim. **Nuk** kam nevojë për më shumë kohë që të vendos.

E jap pëlqimin për:

operacion për drejtimin e murit ndarës të hundës

zvogëlimin e laprës së poshtme të hundës përmes:

koagulimit elektrik dhe me laser të mukozës së hundës

heqjes së mukozës (shkurtimi i mukozës)

zhvendosjes së lapës së hundës anash

heqjes së eshtrave të rritura duke ruajtur mukozën

metodave të tjera

(sipas nevojës, shënoni emrin/emrat e metodave)

mbylljen e një vrime në murin ndarës të hundës përmes

implantimit të mukozës

vendosjes së fletëve prej silikoni

Pajtohem për eliminimin e dhembjeve, për ndryshimet dhe zgjerimet e domosdoshme të paparashikueshme, që mund të dalin gjatë kryerjes së operacionit të planifikuar si dhe për ndërhyrjet ndihmëse dhe pasuese.

Në qoftë se refuzoni masat e caktuara, ju lutemi të shënoni cilat:

Vlen vetëm në rast refuzimi të operacionit:

Nuk e jap pëlqimin për ndërhyrjen e propozuar.

Mjeku më ka sqaruar se cilat rreziqe shëndetësore mund të pasojnë nga refuzimi im.

Vendi, data, ora.

Pacientja / pacienti respektivisht kujdestari/
i autorizuari/kujdestari zyrtar*

Mjekja/mjeku

* nënshkruan vetëm njëri prind, dhe njëkohësisht me nënshkrimin e tij dëshmon që e ka të drejtën e kujdestarit, ose që vepron në pajtim me prindin tjetër.